



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE PRISHTINE

Numri i lëndës: 2019:192172
Datë: 03.06.2024
Numri i dokumentit: 05768729

C.nr.2510/2012

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS - Departamenti i Përgjithshëm, me gjyqtarin Përparim Zeka, në çështjen juridike kontestimore të paditëses N. S., nga Prishtina, përfaqësuar nga S. M., avokat në Prishtinë, kundër të paditurit I. M., nga Prishtina, përfaqësuar nga A. V., avokat nga Prishtina, për anulimin e veprimeve juridike, jashtë seance me datë 03.06.2024, mori këtë:

A K T V E N D I M

I. KONSTATOHET së është tërhequr padia e paditëses N. S., nga Prishtina, kundër të paditurës I. M., nga Prishtina, për anulimin e veprimeve juridike, lënda sipas shenjës C.nr.2510/2012.

II. DETYROHET paditësja që të paditurit t'ia paguaj shpenzimet e procedurës në lartësi prej 1,123.20 €, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të këtij aktvendimi, nën kërcënim të përmbarrimit me detyrim.

A r s y e t i m

Paditësi N. S., nga Prishtina ka ushtruar padi në këtë gjykatë, kundër të paditurit I. M., nga Prishtina në Prishtinë.

I autorizuari i paditësit me parashtresën e datë 22.04.2024, e ka njoftuar gjykatën së në këtë çështje juridike kontestuese e tërheq padinë.

Gjykata në kuptim të dispozitave nga neni 261 e lidhur me nenin 387.1 pika c, të Ligjit për Procedurën Kontestimore, vendosi si ne dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimin që pala paditëse t'i bartë shpenzimet e procedurës Gjykata e ka mbështetur në dispozitën nga neni 456 të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Lartësia e shpenzimeve të

procedurës të aprovuara i referohen shpenzimeve për përpilimin e përgjigjes në padi në shumë prej 312.00€, për përfaqësimin në seancat gjyqësore 812.20€, apo në shumë prej 1,123.20€.

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Departamenti i Përgjithshëm
C.nr.2510/2012, datë 03.06.2024.

Gjyqtari
Përparim Zeka

KËSHILLË JURDIKE:

Kundër këtij aktvendimi nuk është e lejuar ankesa për pikën I të dispozitivit, kurse për pikën II të dispozitivit të aktvendimit është e lejuar ankesa në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimit të së njëjtit, Gjykatës së Apelit të Kosovës, e përmes kësaj gjykate.